

## KONTRATË PËR SHITJEN E PJESEVE TE KAPITALIT

Sot me datë 18/10/2024 ,(tetembdhjete tetor dy mije e njezet e kater) në Tiranë, shtetasit e mëposhtem u ulën dhe redaktuan këtë kontratë shitje kuotash.

### *PALET NE KONTRATE*

1-Ledjon Dedolli , shtetas Shqiptar, lindur ne Klos me 14.04.1996, me numer personal J60414007P, (me poshte referuar si "Shitesi "),

Dhe

2-Urim Muharremi, shtetas Shqiptar , lindur ne Gurre e Madhe me 27.12.1976, me numer personal H61227122I, (me poshte referuar si "Bleresi ")

te dyja palet me aftesi te plote per te vcpruar, me vullnet te lire, duke iu permbajtur dispozitave te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, pranojne te lidhin dhe ne fakt lidhin kete Kontrate per Shitjen e Pjesëve sipas kushteve te meposhtme.

### *Kushtet paraprake*

Shitesi eshte pronar i 1 kuote me vlere nominale 100,000 Leke qe perfaqeson 100% te kapitalit themeltar te Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, te quajtur **Bota Duas SHPK.**, me seli në Tirane , Astir , Rruga Hito Cako, Pallati Devi 2001, Kati 0.

Pala shitesë deklaron se kuotat e shoqerise **Bota Duas** jane plotesisht te lira nga çdo lloj barre e sekuestroje apo pengu.

Pala shitesë deklaron se ka marre prej paleve blerese çmimin e shitjes per 30,000 lekë të 1 kuote që perfaqëson 30% të kapitalit te shoqërisë si më sipër dhe pagesa parashikohet në nenin 2 ,pika 2.2.

Bleresit deshirojne te blejne dhe Shitesi deshiron te shese 30% (Tridhjete përqind) të kapitalit të Shoqerise me vlere 30000 Lekë të zotëruar nga Shitësi, sipas kushteve dhe afateve te mëposhtme;

Bleresi ka analizuar, verifikuar dhe miratuar gjendjen pasurore, financiare dhe kontabile të Shoqërisë në momentin e lidhjes së kësaj kontrate.

Meqë ekzistojnë këto kushte paraprake, palët bien dakort për sa me poshte vijon:

### **Neni 1 - Kushtet Paraprake**

Kushtet paraprake te sipërpermendura janë pjesë perberese e kesaj Kontrate.

### **Neni 2 - Blerja e pjeseve te kapitalit**

2.1. Shitesi merr persiper t'i shese dhe transferoje Bleresit, dhe Bleresi merr persiper te bleje, 30% të kapitalit themeltar te Shoqerisë të zoteruar nga Shitësi, tërësisht të lira nga çfarëdolloj detyrimi ne favor të të tretëve, dhe me një cmim te barabarte me vlerën e tyre nominale 30000 Leke.

2.2. Pagimi i çmimit u be me para në dorë nga ana e Bleresit ne vlere 30,000 Lekë, në momentin e firmosjes së kontratës.

Pronësia i kalon palës blerëse në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Bleresi 1

### **Neni 3 - Detyrime dhe garanci**

Me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe ne çfaredolloj momenti tjeter te metejshem pas lidhjes se saj, Shitesi do t'i garantoje Bleresit, prane selise se Shoqerise, akses ne origjinalet e librave kontabel te Shoqerise dhe cdo dokument tjeter, prone ose sende qe aktualisht jane ne pronesi te Shoqerise, ose qe duhet me pas te behen te Shoqerise.

### **Neni 4 - Korrespondenca**

4.1. Te gjitha njoftimet, kërkesat dhe komunikimet e tjera ndermjet paleve duhet te behen me shkrim dhe te dorezohen prane selise se Shoqerise, dhe prane selise se Bleresit.

4.2. Të gjitha njoftimet, kerkesat dhe komunikimet e tjera do te dergohen me ane te letres rekomande ose me faks.

4.3. Çdo informacion, kerkese ose njoftim do te jete i vlefshem vetem nese ekzistojne kushtet e meposhtme: a) nese eshte derguar me faks, ne momentin ne te cillin eshte marre faksi; b) nese eshte derguar me leter rekomande, ne daten e dorezimit tek marresi qe do te vertetohet me fleten e kthimit.

#### **Neni 5 - Shpenzime dhe taksa**

Shpenzimet legale dhe kontabile, ashtu si edhe çfarëdo shpenzimi tjetër që lidhet me këtë kontratë, si edhe shpenzimet per transaksione te perfshira ne to, do te jene ne ngarkim te pales qe i mbulon. Ne cdo rast, do te jene ne ngarkim te bleresit taksat, taksat e pullave dhe shpenzimet noteriale per lidhjen e kesaj kontrate.

#### **Neni 6 - Trashegimia dhe cedimi**

Kjo kontrate do te detyroje palet dhe do te jete e vlefshme midis tyre, ashtu edhe per trashegimtarete e tyre. Ne cdo rast, asnjera nga palet nuk mundet te kaloje te treteve kontraten pa miratimin me shkrim te pales tjeter.

#### **Neni 7 - Permbajtja e kontrates dhe ndryshimet**

Kjo kontrate perfshin teresisht marredheniet midis paleve dhe zevendeson te gjitha marrevshjet e meparshme qe jane te lidhura me kete objekt. Ndryshime te mundshme ose kufizimet e kesaj kontrate mund te behen vetem me shkrim, te nenshkruara nga te gjitha palet dhe t'i bashkengjiten asaj.

#### **Neni 8 - Origjinalet**

Kjo kontrate hartohet ne 4 (kater) origjinale, ne gjuhen shqipe, te gjitha te nenshkruara nga palet ne daten ....18/10/2024.



### **Neni 9 - Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

Palet angazhohen te zgjidhin me mirekuptim çdo mosmarreveshje qe lidhet me interpretimin dhe ekzekutimin e kesaj Kontrate. Nese nje zgjidhje e tille nuk eshte e mundur, mosmarreveshja do te zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor TIRANE.

### **Neni 10 - E drejta e zbatueshme**

Kjo kontrate dhe te drejtat e detyrimet e paleve do te disiplinohen e ushtrohen ne baze te se drejtes shqiptare.

### **Neni 11 - Vlefshmeria**

Kjo kontrate behet e vlefshme me nenshkrimin e kesaj kontrate nga palet.

Kjo kontrate nenshkruhet nga te dyja palet ne Tirane, me date 18/10/2024.

\* \* \*

Palët pasi lexojnë aktin e mësipërm dhe e gjejnë atë konform vullnetit të tyre të lirë , e nënshkruajnë atë në prezencën e tyre.

Shitesi:

Bleresi:

Ledjon Dedolli

Urim Muharremi

Ledjon Dedolli  


Urim Muharremi  


